



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.600/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizjes VETËVENDOSJE!, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Gjakovës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

PRANOHET E BAZUAR ankesa Anr.600/2025, e datës 20.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik, Lëvizjes VETËVENDOSJE!, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në komunën e Gjakovës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, ashtu që **urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), respektivisht Qendra Komunale e Numërimit në Gjakovë që fletëvotimi në vendvotimin-kutia e votimi më numër 0207/01, të vlerësohen si e vlefshme dhe e njëjta të përfshihen në rezultatin zgjedhor.

A r s y e t i m

Me datë 20.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën theksohet se më 19 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, gjatë procesit të numërimit të votave në SHFMU "Zekeria Rexha" në Gjakovë, ka vërejtur se fletëvotimi nga Vendvotimi më numër 0207/01, është shpallur i pavlefshëm nga komisionerët përkatës, ndonëse Fletëvotimi ka qenë në përputhje me nenin 16 të Rregullores zgjedhore nr. 12/2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit, e gjithë kjo për faktin se në Fletëvotim është vendosur shenja Tik në hapësirën për subjektin politik LVV, me depërtim të lehtë të vijës jashtë katrorit, mirëpo asnjëherë në kundërshtim me rregullat zgjedhore. Pra, në Fletëvotim vërehet qartë qëllimi i votuesit se për cilin subjekt ka votuar, dhe e cila është në përputhje të plotë me nenin 16 të Rregullores zgjedhore nr. 12/2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit, theksohet në ankesë. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë Fletëvotimin.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, bazuar në nenin 3, paragrafi 1.38 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) është institucioni përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve në mënyrë transparente, në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar. Po ashtu, sipas nenit 5, paragrafi 1.4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 Qendra Komunale e Numërimit, ndër funksionet e QKN përfshihet edhe numërimi i fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike. Në lidhje me vlefshmërinë e fletëvotimeve, neni 16, paragrafi 2 i Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 2024 Votimi, Numërimi Në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcakton se një votë është e vlefshme kur është shënuar vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë vullneti i votuesit. Në të kundërtën, vota konsiderohet e pavlefshme nëse: Janë shënuar më shumë se një subjekt politik; Nuk është shënuar asnjë subjekt politik; Janë shënuar vetëm kandidatët, por jo subjekti politik; Qëllimi i votuesit nuk është i qartë. Për të pasur një pasqyrë më të qartë, lidhur me rastin konkret, KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ përkatëse, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim, duke dërguar; *Deklaratën e Kryesuesit të ekipi të numërimit për rastin konkret, i cili spjegon ecurinë e procesit të verifikimit dhe numërimit të këtij fletëvotimi, Librin e votimit dhe përshkrimin e shënimeve për mbarëvajtjen procesit të numërimit në VV në QKN, edhe për rastin konkret, Fletëvotimin që është objekt ankese në rastin konkret, Formularin e Rezultateve për VV konkret.*

Për më tepër, sipas nenit 16, paragrafi 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024, nëse anëtarët e KVV nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është vota e vlefshme apo i pavlefshme, atëherë kryesuesi merr vendimin përfundimtar përkitazi me atë votë dhe këtë rast e evidenton në librin e votimit. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunave përkatëse, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Paneli i vlerësoi si të bazuara pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendon në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Gjakovës, gjatë procesit të numërimit të votave në SHFMU "Zekeria Rexha" në Gjakovë, fletëvotimi nga Vendvotimi më numër 0207/01, është shpallur i pavlefshëm nga komisionerët përkatës, ndonëse fletëvotimi ka qenë në përputhje me nenin 16 të Rregullores zgjedhore nr. 12/2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit, e gjithë kjo për faktin se në Fletëvotim është vendosur shenja Tik në hapësirën për subjektin politik LVV, me depërtim të lehtë të vijës jashtë katrorit.

Paneli ka analizuar pretendimet ankimore dhe provën e paraqitur më saktësisht fotografimin e fletëvotimit, po ashtu edhe përgjigjen në ankesë dhe provat e bashkangjitura nga KQZ dhe ka ardhur në përfundim se pretendimet e ankuesit –subjektit politik Lëvizja VETËVENDOSJE! është e bazuar, dhe se nga ana e Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në Gjakovë,

fletëvotimi në fjalë është shpallur gabimisht i pavlefshëm, në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 16 par. 2 i rregullore Nr.12.2024, për të cilën e urdhëroi KQZ-në, përkatësisht QKN në Gjakovë, që të njëjtën të konsideroi si të vlefshme, të rinumëroi dhe të përfshijë në rezultat. Nga fletëvotimi kuptohet qartë qëllimi i votuesit, nga se është votuar vetëm një subjekt politik, Tiku tërësisht është i vendosur në katrorin pran numrit 118 Lëvizja VETËVENDOSJE!, ndërsa prekja e lehtë e vijës së katrorit më lartë dhe katrorit më poshtë, nuk e bënë të pavlefshme. Nga fletëvotimi kuptohet qartë se votuesi ka votuar vetëm për një Subjekt Politik dhe atë subjektin politik me numër 118. Lëvizja VETËVENDOSJE!

Bazuar në të lartcekurat, paneli duke u mbështetur në nenin 16 par. 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, konstaton se votat konsiderohen të pavlefshme vetëm në rastet si në vijim: Votohet më shumë se një subjekt politik, nuk votohet asnjë subjekt politik, votohet vetëm kandidati e jo subjekti politik, dhe qëllimi i votuesit nuk është i qartë sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim. Prandaj, në rastin konkret fletëvotimi i cili është shpallur i pavlefshëm nuk hyn në kategorinë fletëvotimeve të pavlefshme siç parasheh dispozita ligjore e lartcekur.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 4, lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, lidhur me nenin 13 par.10 nënpar.10.1 të Rregullores së PZAP-së (Nr.01/2024), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.600/2025, datë 21.02.2025

Kryesuese e Panelit
Visleta Husaj Rugova

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.